

DEKLARATA RREGULLATORE

1. Qellimi dhe afatet

1.1. Qellimi i pergjithshem i Deklarates Rregullatore

Miratimi i kesaj deklarate rregullatore synon te mundesoje llogaritjen e tarifave te prodhimit publik te zoteruar nga shteti, te furnizimit me shumice, te shperndarjes dhe furnizimit me pakice te energjise elektrike ne perputhje me metodologjite perkatese te miratuara nga ERE.

1.2. Periudhat e Rregullimit

ERE ka vendosur qe periudha 1 Janar 2009 - 31 Dhjetor 2009 te jete nje periudhe tranzitore gjate se ciles nuk do te kete ndryshim ne tarifat ekzistuese, te percaktuara me Vendimin e saj Nr.21, date 14 Shkurt 2008. Ne kete menyre do t'i jepet mundesia investitorit te vleresoje situaten brenda OSSH¹ dhe te pregatise aplikimin per rishikimin e ketyre tarifave te reja jo me vone se 30 Shtator 2009. Tarifat e reja do te jene efektive duke filluar nga data 01 Janar 2010.

Periudha e pare e rregullimit do te jete 1 Janar – 31 Dhjetor 2010;

Periudha e dyte e rregullimit do te jete 1 Janar - 31 Dhjetor 2011;

Periudha e trete e rregullimit do te jete 1 Janar 2012 – 31 Dhjetor 2014.

Periudhat vijuese te rregullimit do te jene nga 3 deri ne 5 vjet.

1.3. Programi i Tarifave

Ne perputhje me afatet e permendura me lart, deri me 30 Shtator 2009 DSO dhe FPP do te dorezojne aplikimin e tarifave per vitin kalendarik 2009 ("Aplikimi i Rishikimit te Tarifave per vitin 2009") dhe per periudhen e pare te

¹ Per qellimin e kesaj Deklarate Rregullatore termi OSSH nenkupton Shoqerine Aksionere OSSH sh.a. te licensuar nga ERE per te kryer dy funksione: ate te operatorit te sistemit te shperndarjes per operim, mirembajtje dhe zhvillimin e rrjetit (ne tekstin e kesaj deklarate referuar si DSO) dhe funksionin e furnizuesit publik me pakice per klientet tarifore (ne tekstin e kesaj deklarate referuar si FPP).

rregullimit 2010, ne perputhje me metodologjite e tarifave te pershkruara ne kete Deklarate Rregullatore te miratuar, si dhe ne vendimet e meposhtme te ERE-s:

Vendimi Nr. 18, date 14.02.2008;

Vendimi Nr. 75, date 26.06.2008;

Vendimi Nr. 19, date 14.02.2008;

Vendimi Nr. 20, date 14.02.2008;

Vendimi Nr. 21, date 14.02.2008.

ERE do te rishikoje dhe miratoje tarifat per vitin 2009 sipas Aplikimit per Rishikimin e Tarifave per vitin 2009 ("Tarifat e Rishikuara per vitin 2009") jo me vone se 15 Dhjetor 2009. Ndryshimet ndermjet Tarifave te Rishikuara per vitin 2009 dhe tarifave te miratuara fillimisht sipas Vendimit Nr. 21, date 14.02.2008, te shumezuar me sasine e energjise te parashikuar per t'u furnizuar gjate gjithë vitit 2009 te vleresuar nga OSSH ne momentin e pergatitjes se aplikimit per rishikimin e tarifave per vitin 2009, do te sherbeje per te llogaritur shumen e te Ardhurave te Perealizuara te OSSH ne funksionin e saj si Furnizuesi Publik me Pakice (FPP), objekt i Mekanizmit te Kompensimit, te percaktuar ne pikat 5.1 dhe 6 me poshte.

Per vitet ne vazhdim OSSH do te paraqese aplikimin e saj per tarife per nje periudhe te dhene rregullatore ne rastin e DSO-se dhe per nje vit te dhene kalendarik ne rastin e FPP-se, jo me vone se 1 Shtatori i vitit kalendarik qe paraprin ate periudhe rregullatore apo ate vit. ERE do ti aprovoje keto tarifa jo me vone se data 7 Dhjetor i te njejtit vit kalendarik ; tarifat e aprovuara do te behen efektive ne 1 Janar te vitit ne vazhdim. Ne menyre te pavarur nga aplikimet per rishikimin e tarifave, OSSH jo me vone se 2 muaj pas Mbylljes se privatizimit, do te paraqese nje plan investimesh per vitet 2009 dhe 2010 ("Plani i investimeve 2009 dhe 2010"), i cili do te shqyrtohet dhe miratohet nga ERE jo me vone se 2 muaj nga paraqitja e tij.

1.4. Miratimi i Deklaratave Rregullatore vijuese

Jo me vone se 30 Qershor 2014, ERE do te miratoje nje Deklarate Rregullatore per periudhat e rregullimit qe vijojne pas vitit 2014, e cila nuk do te ndryshoje ndjeshem ne metodologji nga kjo Deklarate Rregullatore. Per te menjanuar cdo dyshim, Deklarata Rregullatore e re do te vazhdoje te

permbaje Mekanizmin e Kompensimit, ashtu si pershkruhet ne piken 6 me poshte.

2. Per tarifen e prodhimit te energjise elektrike nga Shoqeria Publike e Prodhimit (PGC):

2.1 Percaktimi i Bazes se Aktiveve te Rregulluara (RAB) per Shoqerine Publike te Prodhimit per vitin 2009

Ne perputhje me metollogjine e llogaritjes se tarifes se prodhimit te energjise elektrike nga PGC, RAB-i per vitin 2009 do te jete i barabarte me vleren kontabel te aktiveve afatgjata sipas bilancit te audituar te PGC sipas Standarteve Nderkombetare te Raportimit Financiar (IFRS) me 31 Dhjetor 2007, plus investimet e vena ne pune gjate vitit 2008, plus investimet e parashikuara nga shoqeria per vitin 2009 dhe te pranuar nga ERE, minus amortizimin per vitet 2008 dhe 2009, plus kapitalin e punes.

2.2 Percaktimi i Normes se Kthimit mbi Kapitalin e vet (RoE) per Shoqerine Publike te Prodhimit (PGC)

Per arsye se shoqeria publike e prodhimit te energjise elektrike do te mbetet prone e shtetit shqiptar, ajo do te kete nje profil risku financiar te ulet. Per me teper, Qeveria Shqiptare nuk kerkon kthime te larta mbi kapitalin e saj. Per rrjedhoje, Norma e Kthimit mbi Kapitalin e vet per shoqerine publike te prodhimit perben nje norme kthimi "jo te bazuar ne treg", qe percaktohet si norma e kthimit mbi Bonot e Thesarit afatshkurtra te emetura nga Banka Qendrore e Shqiperise.

2.3 Raporti i synuar i Borxhit (si perqindje e borxhit ndaj totalit te kapitalit) per Shoqerine Publike te Prodhimit

Per qellim te llogaritjes se tarifes se sherbimit te prodhimit te energjise elektrike, raporti i pranuar i Borxhit do te jete 60% borxh dhe 40% kapital.

2.4 Kapitali i Punes

Kapitali i Punes i lejuar do te jete i barabarte me 1/12 e Shpenzimeve Operative te lejuara per PGC sipas metodollogjise perkatese te llogaritjes se tarifes.

2.5 Niveli vjetor i prodhimit publik me ane te burimeve hidrike

Prodhimi mesatar vjetor me burime hidrike per 10 vitet e kaluara (1999-2008) eshte 4,400 GWh, dhe per 5 vitet e kaluara (2004 – 2008) eshte 4,600 GWh. Meqenese KESH sh.a. perdor nivelin e prodhimit me hidro prej 4,200 GWh per te bere parashikimet vjetore, ka te ngjare qe prodhimi qe do te realizohet per 6 vitet e ardhshme (2009 – 2014) te tejkaluje me rreth 2,500 GWh prodhimin e parashikuar nga KESH, duke siguruar keshtu nje mundesi per minimizimin e riskut hidrologjik dhe mbajtjes relativisht te qendreshme te tarifave te ardhshme te prodhimit te energjise elektrike. Niveli i pergjithshem vjetor i prodhimit te energjise elektrike nga burimet hidrike per kompanine publike te prodhimit te pranuar per periudhat rregullatore te percaktuara ne kete deklarate per qellim te llogaritjes se tarifes se shitjes me shumice nga FPSH tek FPP dhe OST, si dhe per qellim te aplikimit per rishikim te tarifave nga OSSH dhe aprovimin e tarifes nga ERE, eshte 4,200 GWh ne vit– prodhim neto.

3. Per Tarifen e Furnizimit me Shumice nga FPSH

3.1 Marzhi i Fitimit

- Per FPSH eshte i barabarte me 0.5% mbi blerjet vjetore te energjise elektrike.
- Me qellim qe te ulet risku i FPSH, per shkak te riskut hidrologjik qe shoqeron veprimtarine e Shoqerise Publike te Prodhimit, do te behen korigjimet e meposhtme mbi baza vjetore:
 - (i) Pagesa per FPSH do te pershije gjithashtu cdo kosto financimi neto qe rrjedh prej riskut te permendur me lart;
 - (ii) Korigjimin per te mbuluar koston e interesave per mbajtjen e nje linje kredie per te mbuluar kerkesen ne vitet e thata.
 - (iii) Nje korigjim vjetor per nivelin e te ardhurave te teperta apo te munguara te vitit te meparshem te Shoqerise Publike te Prodhimit te shkaktuara nga ndryshimet ne prodhimin aktual vjetor me parashikimin vjetor neto prej 4,200 GWh .

FPSH do te kryeje nje tender mbi baza vjetore, ne perputhje me Ligjin Nr. 9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimet Publike", per blerjen e sasise se energjise elektrike te nevojshme, pervec sasise qe parashikohet per t'u blere nga Shoqeria Publike e Prodhimit.

4. Per Tarifen e Sherbimit te Shperndarjes se Energjise Elektrike

4.1 Percaktimi i Bazes se Aktiveve te Rregulluara (RAB) per DSO-ne.

Vlera e RAB-it per vitin 2009, qe do te perdoret ne Aplikimin per Rishikimin e Tarifave per 2009, do te llogaritet si shuma e :

- (i) Vleres kontabel te aktiveve afatgjate sipas bilancit te audituar sipas Standarteve Nderkombetare te Raportimit Financiar (IFRS) te DSO-se te 31 Dhjetorit 2007, te publikuar;
- (ii) Vleres se investimeve per vitin 2008, e cila do te njhet ne nivelin e jo me pak se 1,900 milion Lek;
- (iii) Vleren e investimeve te parashikuar per t'u realizuar gjate vitit 2009, sipas "Planit te Investimeve 2009 – 2010" te miratuar nga ERE sipas nenit 24 te Ligjit per Sektorin e Energjise Elektrike, te amenduar, dhe pikes 1.3, Programi i Tarifave, te kesaj Deklarate Rregullatore;
- (iv) Vleren e asetave te ndertuara nga KESH (te financuara ekskluzivisht nepermjet borxheve dhe/ ose kapitalit te vet te METEs) per OSSH-ne dhe te transferuara ne OSSH ne vitin 2009 ashtu si konfirmohet nga Vendimi i Keshillit te Ministrave.
- (v) minus amortizimin per vitin 2008 dhe 2009;
- (vi) Vleren e kapitalit te punes te lejuar te barabarte me 1/12 e Shpenzimeve Operative te lejuara te periudhes per te cilen aplikohet.

RAB-i per vitin 2009, i llogaritur si me siper, do te sherbeje si vlere fillestare ne aplikimin per rishikimin e tarifave per periudhen rregullatore 2010. Ky aplikim per tarife do te perfshije vleren e cdo aktivi te ndertuar nga KESH (te financuara ekskluzivisht nepermjet borxheve dhe/ ose kapitalit te vet te METEs) per OSSH-ne dhe te transferuara ne OSSH ne vitin 2010 ashtu si konfirmohet nga nje Vendim i Keshillit te Ministrave.

ERE nuk ka percaktuar nje vlere fillestare per RAB-in megjithate, si nivel fillestar i vleres se aktiveve afatgjata do te sherbeje vlera kontabel e aktiveve afatgjata sipas bilancit te audituar te DSO-se ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar (IFRS) te 31 Dhjetorit 2007, e cila eshte 16,329 milion leke. Aktivet afatgjata te financuara nepermjet granteve do te perjashtohen nga RAB-i. Vlera e aktiveve afatgjata te financuara nepermjet granteve per vitin 2008 (sipas aplikimit te tarifave per vitin 2008) eshte 770 milion leke.

Per vitet e ardhshme, RAB-i do te percaktohet sipas formules se meposhtme:

$$RAB=A-CG-D+WC+INV$$

Ku:

RAB Baza e Aktiveve te Rregulluara ;

A vlera e njohur e aktiveve afatgjata ne sherbim dhe te dobishme ;

CG vlera e aktiveve te perftuara nepermjet granteve apo te ndertuara me burimet financiare te konsumatoreve te energjise elektrike;

D amortizimi i akumuluar nga periudhat e kaluara i aktiveve te perdorura per te kryer aktivitetin e licensuar;

WC kapitali i punes i lejuar, i cili do te jete i barabarte me 1/12 e Shpenzimeve Operative te lejuara te DSO-se;

INV shuma nominale mesatare kumulative e investimeve te parashikuara dhe e miratuar nga ERE, e cila do te investohet gjate periudhes se rregullimit.

4.2 Llogaritja e Kostos Mesatare te Ponderuar te Kapitalit (WACC) per DSO-ne

Per qellim te llogaritjes se tarifave te sherbimit te shperndarjes se energjise elektrike, WACC –u i lejuar nga ERE do te llogaritet mbi baza vjetore, sic pershkruhet ne Metodologjine e Llogaritjes se Tarifes se OSSH, te miratuar me Vendimin e Bordit te ERE-s Nr.79, date 26.06.2008 (Metodologjia e Tarifes) dhe ne kete Deklarate Rregullatore.

Norma e lejuar e Kthimit mbi Kapitalin e vet (ARoE) pas tatim fitimit eshte dhe do te llogaritet sipas formules se meposhtme (Modeli CAPM):

$$R_e = r_f + \beta \times (r_m - r_f)$$

Ku,

β – beta e kapitalit kovarianca ndermjet normes se kthimit ne tregun e kapitaleve dhe normes se kthimit te aksionit individual te nje shoqerie ne te njejten linje biznesi ($\beta=1$ do te thote qe tregu i kapitaleve dhe aksioni kane te njejten ecuri dhe per rrjedhoje risk te padiversifikueshem)

R_m	norma e kthimit te tregun te kapitaleve si nje i tere
$R_m - R_{fr}$	premiumi i riskut te kapitalit te vet.
$R_{fr} + CRP$	norma e kthimit te letrave me vlere me risk zero duke perfshire dhe primin e riskut te vendit, i percaktuar nga kthimi mesatar mbi Bonot e Thesarit (sovereign bonds) me afat 6-mujor te qeverive me risk te krahasueshem me Shqiperine.

Norma e lejuar e kthimit mbi Kapitalin e vet para tatim fitimit per DSO-ne do te jete i barabarte me 16.44% per tre periudhat e para te rregullimit (deri me 31 Dhjetor, 2014). Me pas, ERE do te rishikoje vleren e ARoE-se ne perputhje me Metodologjine e Tarifave, kesaj Deklarate Rregullatore dhe kushteve perkatese te tregut. ERE do te ruaje qendrueshmeri ne parimet e veta dhe ne metodologjine e llogaritjes, sikurse dhe ne burimin e te dhenave qe perdor.

Tabela me poshte paraqet llogaritjen e koston se kapitalit te vet:

Komponentet		
Norma nominale e kthimit per letrat me vlere me risk zero plus primin per riskun e vendit	$R_{fr} + CRP$	7.43%
ERP (primi i riskut te kapitalit te vet)	$R_m - R_{fr}$	5.60%
Perqindja e Borxhit (per Beten)	G	60.00%
Perqindja e Borxhit (per strukturen e kapitalit Borxh/Kapitali i vet)	G	60.00%
Beta per Kapitalin e vet (investim pa borxh)	Beta(U)	0.56
Beta per Kapitalin e vet (investimi perfshin edhe borxh)	Beta(L)	1.32
Norma e Lejuar e Kthimit mbi Kapitalin e vet pas tatim fitimit	$ARoE = R_{fr} + CRP + Beta(L) * ERP$	14.80%
Norma e tatim fitimit	T	10%
Norma e Lejuar e Kthimit mbi Kapitalin e vet para tatim fitimit	$ARoE \text{ para taksave} = ARoE / (1-T)$	16.44%

Per percaktimin e duhur te Normes se Kthimit mbi Kapitalin e vet pas tatim fitimit per DSO-ne, ERE do te mbeshtetet ne vleresimet e parametrave kyc qe do te zbatohen ne metodologjine CAPM, te cilet do te sigurohen nepermjet burimeve publike te disponueshme dhe te besueshme, sic jane: *Bloomberg-*

per vleresimin e normes se kthimit per letrat me vlere me risk zero + primin e riskut te vendit dhe Beta-n per kapitalin e vet; *Ibbotson Associates*- per vleresimin e primit te riskut te kapitalit te vet. Ne mungese te publikimeve nga keto burime, ERE do te mbeshtetet ne nje vleresim te pavarur qe rrjedh nga nje burim me besueshmeri te krahasueshme.

Per sa i perket koston e borxhit te ri ne modelin e llogaritjes se WACC-ut, ERE do te perdore vleresimin me te fundit te koston mesatare te ponderuar te borxhit te ri te perftuar nepermjet procedurave transparente te tenderimit, si norme interesi per borxhet e reja sipas percaktimit me poshte.

OSSH do te zgjedhe bankat per te siguruar borxhin e ri ne perputhje me procedurat e tenderimit, qe do te propozohen nga vete ajo jo me vone se fundi i Shkurtit 2009. ERE do te miratoje keto procedura jo me vone se Mbyllja e privatizimit te OSSH –se. Keto procedura do te jene te drejta, transparente dhe ne perputhje me ligjet dhe praktikat me te mira. Keto procedura do te jene te vlefshme per periudhen kohore qe mbulon kjo Deklarate Rregullatore.

OSSH do te kete gjithashtu te drejten te marre borxh nga huadhenes nderkombetare, duke perfshire pa kufizim EBRD dhe IFC, ne rastin ne te cilin keto procedura tenderimi nuk do te jene te zbatueshme. Kosto e borxhit te ri te marre nga OSSH ne perputhje me keto procedura (ose sipas rastit, te marre nga huadhenes nderkombetare sipas fjalise me siper) do te jete plotesisht e transferueshme ne tarifen perkatese nepermjet modelit te llogaritjes se WACC-ut te shpjeguar ne kete seksion.

Ne rast se borxh i ri nuk eshte e mundur te perftohet nepermjet ketyre procedurave te tenderimit, dhe/apo nga institucionet financiare nderkombetare, aksioneret e OSSH-se mund te sigurojne, si burim te fundit, financim shtese per te siguruar mbarevajtjen e veprimtarise se OSSH-se. Kosto e ketij financimi do te jete e njejte me normen e lejuar te kthimit mbi kapitalin e vet (ARoE), te pershkruar me siper, dhe do te jete plotesisht e transferueshme ne tarifen e miratuar si komponent borxhi nepermjet modelit te llogaritjes se WACC, sic pershkruhet ne kete seksion. OSSH do te paraqese ne ERE fakte te arsyeshme qe tregojne se ajo ka bere perpjekjet me te mira per perftimin e financimeve te tilla nepermjet ketyre procedurave.

Borxhi i ri i marre nga OSSH ne perputhje me procedurat e pershkruara me lart (ose sipas rastit, te marre nga huadhenesit nderkombetare sipas fjalise me lart), dhe/apo nga financimi i aksionereve sipas paragrafit me lart, do te konsiderohet si borxh i ri ("Borxh i Ri").

Norma e interesit e pranuar per borxhin e vjeter eshte norma aktuale e interesit te aplikueshem sipas termave te marreveshjes se nen – huase

ndermjet KESH sh.a. dhe OSSH sh.a.. "Borxhi i Vjeter" i referohet borxhit te llogaritur per DSO-ne ne perputhje me marreveshjen per shlyerjen e borxhit afat-gjate qe do te nenshkruhet ndermjet KESH sh.a. dhe OSSH sh.a. ("Mareveshja e Shlyerjes se Borxhit Afatgjate").

Kosto Mesatare e Ponderuar e Kapitalit (WACC) llogaritet si vijon:

$$\text{CoOD\%} * \text{OldL-T}/(\text{OldL-T} + \text{NewL-T}) = \text{Y1\%}$$

$$\text{CoND\%} * \text{NewL-T}/(\text{OldL-T} + \text{NewL-T}) = \text{Y2\%}$$

$$\text{WACC} = 40\% * \text{ARoE\% para taksave} + 60\% (\text{Y1\%} + \text{Y2\%})$$

Ku:

ARoE% para tatim fitimit	= Norma e Lejuar e Kthimit mbi Kapitalin para tatim fitimit
CoOD%	= Norma aktuale mesatare e ponderuar e interest per Borxhin e Vjeter
CoND%	= Norma aktuale mesatare e ponderuar e interesit per Borxhin e Ri
OldL-T/(OldL-T + NewL-T)	= Pjesa e Borxhit te Vjeter ne totalin e Borxhit
NewL-T/(OldL-T + NewL-T)	= Pjesa e Borxhit te Ri ne totalin e borxhit
OldL-T	= borxhi i mbetur per t'u paguar nga OSSH sipas temave te Marreveshjes se Shlyerjes se huase afatgjate, ne vleren aktuale sipas bilancit te audituar te OSSH sipas IFRS-ve per vitin perpara vitit te aplikimit per tarife.
NewL-T	= borxhi i mbetur, me norme interesi, pervec atij qe mbart Borxhi i Vjeter, te marre nga OSSH, ne vlere aktuale sipas bilancit te audituar te OSSH sipas IFRS-ve per vitin perpara vitit te aplikimit per tarife.

4.3 Raporti i synuar i Borxhit per DSO-ne

Per qellim te llogaritjes se tarifave te sherbimit te shperndarjes se energjise elektrike, raporti i pranuar i borxhit do te jete 60%, sic tregohet ne formulen me siper.

4.4 Kapitali i Punes

Kapitali i Punes i lejuar do te jete i barabarte me 1/12 e Shpenzimeve Operative te DSO-se (shpenzimet operative te lejuara), sipas metodologjise se llogaritjes se tarifave te sherbimit te shperndarjes se energjise elektrike. Vetem per qellim te llogaritjes se Kapitalit te Punes, Shpenzimet Operative perfaqesojne kostot operative vjetore te lejuara per DSO-ne qe te kryeje veprimtarine per te cilen eshte licensuar, duke perjashtuar amortizimin e aktiveve afatgjata dhe shpenzimet financiare. Shpenzimet qe lidhen me blerjen e energjise elektrike per te mbuluar humbjet ne rrjetin e shperndarjes perfshi te gjitha kostot e aplikueshme te transmetimit jane gjithashtu pjese e Shpenzimeve Operative te lejuara.

Niveli i Shpenzimeve Operative i miratuar ne tarifate e vitit 2008 ishte 21,000 milion Leke per DSO-ne dhe 1,800 milion Leke per FPP.

Parashikimi me i fundit i Shpenzimeve Operative per vitin 2009 sipas aplikimit perkates per rishikim te tarifave (sidoqofte jo me i ulet se niveli i Shpenzimeve Operative per vitin 2008 i pershkruar me lart) do te sherbeje si baze per llogaritjen e Tarifave te Rishikuara per vitet 2009 dhe 2010. Parashikimi i kostos se energjise per te mbuluar koston e humbjeve te DSO-se per pjesen e vitit 2009 qe mbetet pas Mbylljes se privatizimit dhe per vitin 2010 nuk do te marre parasysh efektin e ndonje korigjimi ne koston e vleresuar te DSO-se dhe/ose FPP, qe ka lidhje me vendimin e Qeverise No. 143, date 11.02.2009 (Per Nje Shtese ne Vendimin Nr. 338, Date 19.03.2008, te Keshillit te Ministrave, "Per Miratimin e Modelit te Tregut te Energjise Elektrike", Te Ndryshuar). Per te menjanuar cdo dyshim, shpenzimet qe lidhen me Auditimin e Humbjeve dhe Studimin e Humbjeve, Studimin e Nivelit te Borxhit te Keq dhe te Garancise e Pjesshme te Riskut (PRG) qe do te merret nga Banka Boterore, do te pranohen dhe njihen nga ERE si te arsyeshme per t'u perfshire ne Shpenzimet Operative.

4.5 Objektivat per uljen e humbjeve

Per vendosjen e objektivate te uljes se humbjeve ne shperndarje pergjate periudhave te rregullimit, per vitin 2008 do te supozohet nje nivel i pritshem i

humbjeve prej 32% te energjise se injektuar ne rrjetin e shperndarjes. Perqindja e humbjeve te energjise elektrike ne shperndarje do te kuptohet si diference ndermjet energjise qe injektohet ne rrjetin e shperndarjes dhe energjise se faturuar konsumatoreve tarifore, e treguar si perqindje ndaj energjise se injektuar ne sistemin e shperndarjes

Deri me sot nuk eshte kryer ndonje studim i vecante per humbjet ne sistemin e shperndarjes, por per qellim te vendosjes se tarifave, sipas vleresimeve te OSSH-se, ERE pranon qe niveli total i humbjeve ne shperndarje (teknike dhe jo-teknike) te arrije ne 15 % ne fund te periudhes se trete te rregullimit (viti 2014), me supozimin qe niveli fillestar ne vitin 2008, per t'u konfirmuar nga Auditimi i Humbjeve sipas pershkrimit me poshte, eshte ne nivelin prej 32%.

ERE pret nje permiresim te shpejte ne nivelin e humbjeve jo – teknike, dhe nje ulje me te ngadalshme por te vazhdueshme te humbjeve teknike ne rrjetin e shperndarjes. ERE parashikon uljen e humbjeve totale ne sistemin e shperndarjes sipas skenarit ne vijim:

4% (pike perqindje) ulje per periudhen e pare te rregullimit;

4% (pike perqindje) ulje per periudhen e dyte te rregullimit;

9% (pike perqindje) ulje per periudhen e trete te rregullimit (3*3%).

Jo me vone se 31 Korrik 2009, DSO do te kryeje nje auditim te detajuar te humbjeve ("Auditimi i Humbjeve") per te percaktuar metodologjine per llogaritjen e humbjeve te pergjithshme dhe per te verifikuar nivelin aktual te humbjeve per vitin 2008 ("Humbjet Aktuale te vitit 2008").

Jo me vone se 31 Korrik 2010, DSO do te kryeje nje studim te detajuar per humbjet ("Studimi i Humbjeve") per te percaktuar humbjet teknike dhe jo teknike te realizuara per vitin 2009.

Auditimi i Humbjeve dhe Studimi i Humbjeve do te pergatiten nga nje ekspert teknik i pavarur qe do te zgjidhet nga lista e meposhtme:

- Arthur D.Little
- Deloitte
- Ernst & Young
- KPMG
- PricewaterhouseCoopers

Studimi i Humbjeve dhe Auditimi i Humbjeve do te miratohen nga ERE perkatesisht brenda 2 muajve dhe 1 muaji nga data e paraqitjes se tyre.

Humbjet Aktuale per vitin 2008 te verifikuara sipas Auditimit te Humbjeve do te sherbejne si baze per llogaritjen e Tarifave te Rishikuara per vitet 2009 dhe 2010. Ne te njejten kohe, niveli i Humbjeve Aktuale per vitin 2009 do te pranohet i barabarte me nivelin aktual te vitit 2008 dhe do te jete plotesisht i transferueshem ne tarifate e DSO-se ne perputhje me Mekanizmin e Kompensimit te pershkruar ne piken 6, dhe do te sherbeje si nivel fillestar per programin e uljes se humbjeve ne periudhat e percaktuara me siper.²

Duke u bazuar ne Studimin e Humbjeve, DSO do te propozoje ne ERE programin e uljes se humbjeve totale per te tre periudhat e rregullimit te permendura me lart, te ndara ne vite, te shoqeruara me planin perkates te investimeve te nevojshme per uljen e humbjeve sipas ketij programi, nese skenari i propozuar nga ERE nuk eshte i pershtatshem. Per te menjanuar cdo dyshim niveli i humbjeve totale nuk mund te jete me i ulet se 15% ne fund te periudhes se trete rregullatore (2014).

Niveli i investimeve te nevojshme per uljen e humbjeve sipas programit te paraqitur nga DSO do te miratohet nga ERE ne perputhje me nenin 24 te Ligjit per Sektorin e Energjise Elektrike, te ndryshuar.

ERE eshte e vetedijshme qe DSO nuk duhet te perballat me riskun qe rrjedh nga prokurimi i energjise elektrike ne tregun e hapur. Kosto e humbjeve te njohura per qellim te llogaritjes se tarifave se sherbimit te shperndarjes se energjise elektrike per vitin e ardhshem do te percaktohet si kosto mesatare e ponderuar e blerjes një vit në avancë të energjise nga DSO shumezuar me sasine e pritshme te energjise elektrike te nevojshme per mbulimin e humbjeve.

Per te menjanuar cdo dyshim, OSSH cdo vit kalendarik do te shpalle tendera per blerjen e energjise elektrike ne perputhje me procedurat e tenderimit qe do te propozohen nga DSO, jo me vone se fundi i muajit Shkurt 2009, dhe do te miratohen nga ERE jo me vone se Mbyllja e privatizimit te OSSH. Keto procedura do te jene te drejta, transparente dhe ne perputhje me ligjet ne fuqi dhe praktikate me te mira. Keto procedura do te jene te vlefshme per periudhen qe do te jete e vlefshme kjo Deklarate Rregullatore. Kosto e humbjeve e percaktuar ne perputhje me keto procedura do te jete plotesisht e transferueshme ne tarifate e shperndarjes te miratuara per vitin pasardhes.

4.6. Faktori - X

4.6.1 Faktori X per tre periudhat e para te rregullimit do te jete zero,

4.6.2 ERE do te njohet cdo perfitim qe vjen si rezultat i uljes se shpenzimeve operative (perjashtuar humbjet) i cili do t'i lihet investitorit per nje

² (p.sh. nese Humbjet Aktuale te vitit 2009 jane 33%, niveli perfundimtar i humbjeve ne 31.12.2014 do te jete 16%.l

periudhe rregullimi. Koriggjimi i Shpenzimeve Operative per periudhen pasardhese te rregullimit do te jete objekt rishikimi nga ERE.

5. Per Tarifen e Furnizuesit Publik me Pakice

5.1 Tarifa e Furnizuesit Publik me Pakice

Te Ardhurat e Kerkuara Furnizuesit Publik me Pakice (tarifa e konsumatoreve fundore) do te llogaritet duke u bazuar ne metodollogjine e pershkruar me poshte, duke njohur gjithashtu sasine e te ardhurave te llogaritur per t'u kompensuar sipas mekanizmit te kompensimit te pershkruar ne Piken 6.:

$$RR_{act\ n} = (WPS_{tariff\ n} + OST_{tariff\ n}) \times V_n + DSO_{tariff\ n} \times V_{dn} + PSO_{costsn} + RPS_{costs} - \Delta COMPB_n$$

Ku:

$$\Delta COMPB_n = RR_{cal\ n} - RR_{max\ n}$$

$$RR_{max\ n} = T_{act\ n-1} \times (1+g) \times (1+CPI_{n-1}) \times V_n$$

$$COMPB_n = COMPB_{n-1} + RoC_n + \Delta COMPB_n$$

$$RoC_n = [COMPB_{n-1} + \max(RR_{cal\ n} - RR_{max\ n}; 0)] \times WACC_Comp_n$$

$$nese \quad COMPB_{n-1} + RoC_n + \Delta COMPB_n \leq 0,$$

$$atehere \quad \Delta COMPB_n = -(COMPB_{n-1} + RoC_n)$$

Variablat e mesiperm percaktohen si vijon:

$RR_{act\ n}$ – kerkesa aktuale per te ardhura e OSSH e njohur nga ERE ne vitin n, ne funksion te veprimtarise se shitjes me pakice qe ajo kryen

$RR_{max\ n}$ – niveli i te ardhurave maksimale te OSSH te lejuar nga ERE ne vitin n, ne funksion te veprimtarise se shitjes me pakice qe ajo kryen, ne kuptimin e normes maksimale reale te rritjes se tarifes mesatare te FPP.

$RR_{cal\ n}$ – kerkesa per te ardhura e OSSH e njohur ne funksion te veprimtarise se shitjes me pakice, sipas aplikimit per rishikim te tarifave (pa ndikimin e balances se kompensimit)

$COMPB_n$	– gjendja e llogarise se kompensimit per fundin e vitit n. Per vitin 2008 kjo shume eshte e barabarte me zero.
$\Delta COMPB_n$	– ndryshimi i gjendjes se akumuluar te llogarise se kompesimit – gjate vitit n .
g	– rritja vjetore mesatare e ponderuar e tarifave te konsumatoreve fundore ne terma reale (duke perjashtuar CPI) e pranuar nga ERE, g do te jete e barabarte me /ose me e larte se 15 %,per aq kohe sa ka akoma shuma pozitive te mbetura per tu kompesuar ne llogarine e kompesimit
$ \Delta COMPB_n $	– vlera absolute e $\Delta COMPB_n$ ne vitin n
$WACC_Comp_n$	– norma e lejuar e kthimit mbi balancen e llogarise se kompesimit – per vitin n ; sipas Pikes 6 $WACC_Comp_n$ do te jete e barabarte me Koston Mesatare te Ponderuar te Kapitalit (WACC) te llogaritur per DSO –ne per vitin n , sipas Pikes 4.2.
RoC_n	– kthimi i perftuar ne vitin n mbi balancen e llogarise se kompensimit
$T_{act\ n}$	– tarifa mesatare totale e ponderuar per FPP e miratuar nga ERE ne vitin n
V_n	– sasia totale e energjise elektrike per konsumatoret tarifore e pranuar nga ERE dhe OSSH per vitin n
V_{dn}	- sasia totale e shitjeve te energjise tek konsumatoret tarifore te lidhur ne sistemin e shperndarjes ne vitin n , te pranuar nga ERE dhe OSSH per vitin n .
CPI_n	– Indeksi i Cmimeve te Konsumit i fund vitit ne vitin n i publikuar ne buletin e Institutit te Stattistikes ne Shqiperi (INSTAT) ³
$WPS_{tariff\ n}$	– Tarifa e kerkuar e furnizuesit publik me shumice te energjise elektrike e miratuar nga ERE ne vitin n

³ Per te menjanuar cdo dyshim, CPI ne vitin 2007 ishte 3.1% dhe ne vitin 2008 ishte 2.2% te publikuara nga INSTAT ne Dhjetor 2008.

$OST_{\text{tariff } n}$	– Tarifa e kerkuar e operatorit te sistemit te transmetimit te energjise elektrike e miratuar nga ERE ne vitin n
$DSO_{\text{tariff } n}$	– tarifa e sherbimit te shperndarjes se energjise elektrike e miratuar nga ERE ne vitin n
$PSO_{\text{costs } n}$	– kostot qe lidhen me detyrimet e sherbimit publik e miratuar nga ERE ne vitin n
$RPS_{\text{costs } n}$	– kostot e furnizuesit publik me pakice te miratuara nga ERE ne vitin n. Kjo kosto do te perfshije marzhin e fitimit ashtu si specifikohet ne piken 5.3 me poshte

Nese per ndonje arsye tarifa e FPP nuk do te jete më e rregulluar (sipas rastit, nese realizohet ndarja e veprimtarise se furnizimit me pakice nga ajo e shperndarjes se energjise elektrike), dhe gjendja e llogarise se kompensimit nuk eshte realizuar plotesisht tek te ardhurat e OSSH –se, atehere kjo shume e mbetur ne llogarine e kompensimit do te transferohet tek DSO dhe do te rimburohet/shlyhet ne perputhje me metodollogjine e pershkruar me lart nepermjet tarifes se DSO-se.

5.2 Borxhi i Keq

ERE eshte e vetedijshme se nje nivel i caktuar i borxhit te keq eshte pjese e pandare e biznesit te shitjes me pakice te energjise elektrike dhe si e tille duhet reflektuar ne tarifa. Borxhi i Keq i Lejuar do te llogaritet si nje perqindje mbi shumen e te ardhurave totale te OSSH ne funksionin e saj si FPP perfshire te gjithë perberesit e tarifave te FPSH (perfshire ate te prodhimit), te OST, DSO, PSO, FPP dhe pagesa te tjera sipas rastit duke perjashtuar tatimin mbi vleren e shtuar („Te Ardhurat e FPP“). Per vendosjen e objektivave per uljen e Borxhit te Keq pergjate periudhave te rregullimit, do te pranohet per vitin 2008 nje nivel i Borxhit te Keq prej 14 % mbi te Ardhurat e FPP.

Per 2009 pranohet i njejti nivel i Borxhit te Keq me ate te vitit 2008 (si % ndaj te Ardhurave te FPP). Ne 2010, niveli i Borxhit te Keq (si % ndaj te Ardhurave te FPP) do te ulet me 1 pike perqindje krahasuar me nivelin e vitit 2009.

Deri me 31 Korrik 2011, OSSH, ne funksion te veprimtarise se shitjes me pakice qe ajo kryen, do te kryeje nje studim te detajuar per Borxhin e Keq (“Studimi mbi Borxhin e Keq”) per te percaktuar (i) metodollogjine e llogaritjes se Borxhit te Keq dhe (ii) Nivelet Aktuale te Borxhit te Keq per 2008, 2009 dhe 2010 („Nivelet Aktuale

te Borxhit te keq per vitet 2008, 2009 dhe 2010"). Studimi mbi Borxhin e Keq do te pergatitet nga nje ekspert financiar i pavarur i zgjedhur nga lista e meposhtme:

- Deloitte
- Ernst & Young
- KPMG
- PricewaterhouseCoopers

Studimi mbi Borxhin e Keq do te miratohet nga ERE Brenda 2 muajve nga paraqitja e tij.

Gjithashtu, niveli aktual i Borxhit te Keq per vitin 2010 do te sherbeje si nje nivel fillestar per programin ne vazhdim te uljes se tij sipas pershkrimit me poshte ne rast se ai nuk eshte me i larte se niveli aktual i borxhit te keq te vitit 2009, perndryshe do te perdoret borxhi i keq aktual i vitit 2009.

1% (pike perqindje) ulje per vitin 2011;

1% (pike perqindje) ulje per vitin 2012;

1% (pike perqindje) ulje per vitin 2013.

1% (pike perqindje) ulje per vitin 2014.

Ne rast se Niveli Aktual i Borxhit te Keq per 2009 dhe/apo 2010 dhe/apo 2011⁴ eshte perkatesisht me i larte se 14 % dhe /apo 13% dhe/apo 12%, diferenca do te shtohet ne shumen e te ardhurave per t'u kompensuar sipas Pikes 6.

Ne rast se Niveli Aktual i Borxhit te Keq per 2009 dhe/apo 2010 dhe/apo 2011 eshte perkatesisht me i ulet se 14 % dhe /apo 13% dhe/apo 12%, diferenca do t'i zbritet shumes se te ardhurave per t'u kompensuar sipas Pikes 6.

5.3. Te tjera

- Tarifa e sherbimit te furnizimit me shumice do te jete kosto e transferueshme per Furnizuesin Publik me Pakice.
- Marzhi i Fitimit per Furnizuesin Publik me Pakice eshte i barabarte me 2.2 % mbi shpenzimet vjetore per blerjen e energjise elektrike nga FPSH-ja me cmime te rregulluara. Marzhi i Fitimit per FPP –ne bazohet vetem ne blerjet e energjise elektrike nga FPSH dhe nuk llogaritet bazuar ne kostot e

⁴ Niveli Aktual i Borxhit te Keq per vitin 2011 percaktohet si Niveli aktual i Borxhit te Keq per vitin 2010 minus 1 pike perqindje.

sherbimeve te transmetimit, shperndarjes apo atyre te sherbimeve ndihmese, madje as ne kostot qe lidhen me blerjen e energjise elektrike nga DSO –ja per mbulimin e humbjeve.

- Lidhur me strukturen e tarifave te konsumatoreve familjare, ERE ka filluar nje studim per percaktimin e nivelit minimal te konsumit mesatar mujor. ERE do te beje te mundur venien ne dispozicion te DSO-se se rezultateve te ketij studimi perpara se OSSH te pregatise aplikimin per rishikimin e tarifave, pra jo me vone se 30 Qershor, 2009. Rezultatet e ketij studimi do te perdoren per rishikimin e nivelit te bllokut te pare te konsumit per konsumatoret familjare, ne aplikimin per rishikimin e tarifave qe do te hyjne ne fuqi me 01 Janar, 2010.
- Tarifa e FPP-se per konsumatoret tarifore do te perfshije nje korigjim per te kompensuar FPP-ne per ndryshimet ndermjet te ardhurave te parashikuara dhe atyre te realizuara si rezultat i ndryshimeve ne kerkesen e parashikuar per cdo kategori te konsumatoreve, kur keto te fundit jane te krijuar rishtasi ose kur ka ndryshime ne tarifate, te cilat nuk jane ne te njejtin proporcion tek te gjitha kategorite e konsumatoreve.

6. Mekanizmi i Kompensimit per Tarifen e Sherbimit te Shperndarjes dhe te Shitjes me Pakice te Energjise Elektrike

Ne rast se ERE nuk lejon ne tarife nje pjese te te Ardhurave te Kerkuara te njohura per DSO-ne dhe FPP-ne, te llogaritura sipas metodologjive perkatese te miratuara nga Bordi i Komisionereve te EREs me vendimet Nr. 79 dhe 80 te dates 26.06.2008, atehere kjo pjese e te ardhurave do te jete objekt i mekanizmit te kompensimit te pershkruar me poshte ashtu si eshte percaktuar ne piken 5.1.

Ne rast se kerkesa per te ardhura e OSSH-se ne funksionin e saj si FPP per nje vit te dhene rezulton me nje rritje te tarifes totale mesatare te ponderuar per konsumatoret tarifore (shuma e te ardhurave te kerkuara te OSSH-se ne funksionin e saj si FPP pjestuar me volumin vjetor te parashikuar te shitjeve ne nje vit te dhene) me te larte se 15 % ne terma reale (mbi CPI)⁵, atehere rritja minimale e tarifes mesatare e njohur nga ERE do te jete 15 % ne terma reale. Per te menjanuar cdo dyshim, kjo tarife do te sjelle rritjen minimale ne te ardhurat e kerkuara te OSSH-se ne funksionin e saj si FPP prej 15 % ne terma reale.

Nese rritja e kerkuar e tarifes fundore totale mesatare te ponderuar per vitin e ardhshem (perpara aplikimit te ndonje sasie te ardhurash per tu kompesuar me mekanizmin e kompensimit) eshte me e ulet se 15 % ne terma reale, ERE do te miratoje nje rritje te tille dhe nuk do te rrise shumen e te ardhurave per

⁵ Rritja ne terma reale do te llogaritet duke perdorur formulen $(1+g) \times (1+CPI_{n-1})$

t'u kompensuar. Per me teper, nese ka gjendje te mbetur ne llogarine e kompesimit, ERE do te rrise tarifen mesatare te ponderuar te konsumatoreve fundore ne nivelin e duhur per te bere zero llogarine e kompesimit, mjaft qe kjo rritje tarife nuk eshte me e madhe 15 % ne terma reale, sipas formules ne piken 5.1. me siper. Cdo pjese e mbetur ne llogarine e kompesimit do te mbartet per vitin tjeter.

Pjesa e te ardhurave qe nuk eshte marre parasysh ne llogaritjen e tarifes, do te perbeje llogarine e kompesimit qe nga viti kur kjo ndodh deri ne vitin (duke perfshire edhe kete vit) kur kjo sasi kompensohet plotesisht sipas formules se pershkruar ne Piken 5.1. Gjate periudhes se kompesimit OSSH ka te drejte te fitoje kthimin e rregulluar mbi kete shume – objekt i mekanizmit te kompesimit. Norma e lejuar e kthimit per t'u perftuar mbi shumen e kompesimit do te jete e barabarte me Koston Mesatare te Ponderuar te Kapitalit (WACC) te llogaritur per DSO-ne, sipas pikes 4.2, per vitin paraardhes te vitit kur behet aplikimi per tarife.

Mekanizmi i kompesimit do te zbatohet pergjate periudhes qe mbulon kjo Deklarate Rregullatore dhe do te ruhet gjithashtu per periudhat e ardhshme te rregullimit.

Ndryshimi ne kerkesen e pergjithshme per te ardhura qe rrjedh nga ndryshimi i tarifave te miratuara per vitin 2009 sipas Vendimit Nr. 21, date 14.02.2008 dhe tarifave sipas "Aplikimit per Rishikimin e Tarifave per 2009", do te jete objekt i Mekanizmit te Kompensimit.

Ne rast se humbjet aktuale per vitin 2008 jane me te larta se sa niveli i supozuar prej 32 %, dhe per rrjedhoje Humbjet Aktuale per vitin 2009 jane gjithashtu me te larta se 32%, atehere ndryshimi ndermjet kerkeses per te ardhura te llogaritur sipas programit te ri te uljes se humbjeve dhe kerkeses per te ardhura te llogaritur sipas programit fillestar te uljes se humbjeve (bazuar ne nivelin e pranuar te humbjeve prej 32%), sic pershkruhet ne kete dokument, do te jete gjithashtu objekt i mekanizmit te kompesimit.

Ne rast se Niveli Aktual i Borxhit te Keq per 2009 dhe/apo per 2010 dhe/apo Niveli aktual i Borxhit te Keq per 2011 eshte perkatesisht me i larte se 14 % , 13 % dhe/ apo 12% atehere ndryshimi ndermjet kerkeses per te ardhura te llogaritur sipas programit te ri te uljes se Borxhit te Keq dhe kerkeses per te ardhura te llogaritur sipas programit fillestar te uljes se Borxhit te Keq (bazuar ne nivelin e Borxhit te Keq perkatesisht 14 %, 13 % dhe 12%), si pershkruhet ne kete dokument, do te jete gjithashtu objekt i mekanizmit te kompesimit.

7. Cilesia e Sherbimit te Furnizimit me Energji Elektrike

- ERE ka percaktuar vetem dy tregues te cilesise se sherbimit derisa te pergatiten standartet per cilesine e sherbimit:
 - Nderprerjet e furnizimit me energji elektrike (shpeshtesia dhe kohezgjatja) qe do te kryhen nga DSO-ja ne raste riparimesh dhe remontesh. DSO-ja duhet t'i paraqese ERE-se programin e remonteve mbi baza vjetore.
 - Saktesia e faturimit 99 %. Saktesia e faturimit eshte kritike per te reduktuar humbjet dhe per te qene te drejte ndaj konsumatoreve. Per me teper ERE-ja dhe DSO-ja/FPP-ja, duhet te punojne se bashku per te vendosur rregulla per shpeshtesine e leximit te matesave dhe se si do te ndahet konsumi i energjise elektrike per cdo muaj ne rastet kur nje mates lexohet me rralle se nje here ne muaj.

Standartet per cilesine e sherbimit te furnizimit do t'i propozohen ERE-s nga investitori ne bashkepunim me te licensuar te tjere. Standartet do trajtojne cilesine dhe gjithashtu edhe sigurine e furnizimit me energji elektrike. ERE parashikon qe ky proces te zgjase rreth 1 vit per FPP dhe DSO, derisa ata te analizojne sistemin, te zhvillojne nivelet e krahasimit per cdo standart te cilesise dhe sigurise se furnizimit, dhe te zhvillojne programet per te arritur keto objektiva.

8. Dispozita perfundimtare

Sikurse ne te gjitha dokumentat zyrtare te miratuara nga ERE, versioni shqip i ketij dokumenti eshte versioni zyrtar.

Ne rastin e ndonje mosperputhjeje ndermjet Deklarates Rregullatore dhe ndonje vendimi tjeter te ERE-s, kjo Deklarate Rregullatore do te prevaloje.

9. Miratimi

Kjo Deklarate Rregullatore u miratua nga Bordi i Komisionereve me Vendimin Nr. 12, date 03.03.2009.